



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE

Nr. 1, datë 26.07.2017

**PËR MBLEDHJEN E TË ARDHURAVE
TË
BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

ndryshuar me

RREGULLOREN

Nr. 3, datë 22.02.2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN NR. 1 DATË
26.07.2017 “PËR MBLEDHJEN E TË ARDHURAVE TË BORDIT TË
MBIKËQYRJES PUBLIKE”**

Kjo rregullore është hartuar në bazë të:

Nenit 4/1, 5, 13 pika c, 18 pika 8 dhe 57 të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i kësaj rregullore

1. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore për financimin dhe burimet e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe administrimin e tyre.
2. Kjo rregullore parashikon dispozitat që rregullojnë burimet e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe mënyrën e mbledhjes së tyre si dhe çdo formë alternative të gjenerimit të të ardhurave prej menaxhimit të mjeteve financiare në përputhje me legjislacionin Shqiptar.
3. Në këtë rregullore parashikohen edhe rregullat e administrimit të këtyre të ardhurave.

Neni 2

Shkurtime dhe Përkufizime

1. Shkurtime e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

NIP – Njësi ekonomike me interes publik

BMP - Bordi i Mbikëqyrjes Publike

SM – Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

KPAP - Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

KM – Kontabilist i Miratuar

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

Të ardhura - i referohet burimeve të financimit për mbarëvajtjen e aktivitetit të BMP-së të në përputhje me kërkesat ligjore për ligjin mbi auditimin.

Paaftësi paguese - me paaftësi paguese për qëllime të kësaj rregullore do të kuptohet kur audituesi apo shoqëria audituese ka mjaftueshëm aktive të paguaj detyrimet që ka por nuk ka mjaftueshëm mjete monetare për të bërë pagesën.

Kandidat - me termin kandidat për qëllime të kësaj rregullore do të konsiderohet të gjithë ata persona që kanë mbyllur rishtazi me sukses provimet përkatëse përfundimtare të aftësimit profesional brenda sezonit për të cilin akordohet shpërblimi/bursa.

Evidenca mbështetëse - me evidenca mbështetëse për qëllime të kësaj rregullore do të kuptohet i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike kundrejt Audituesit apo Shoqërive Audituese.

Ligji për auditimin - ligji nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2 të ligjit për auditimin.

Neni 3

Depozitimi i të ardhurave

1. Të gjitha të ardhurat e mbledhura për llogari të BMP do të depozitohen në llogari bankare specifike në bankën e nivelit të dytë.
2. Të gjitha shpenzimet e BMP do të realizohen me anë të transaksioneve bankare.
3. Për llogari të BMP do të çelen të paktën 2 (dy) llogari rrjedhëse në Lekë dhe të paktën një llogari rrjedhëse në Euro në dy prej bankave të nivelit të dytë. Njëra prej llogarive

në Lekë dhe llogaria në Euro do të përdoren për transaksionet e BMP dhe llogaria tjetër do të përdoret për arkëtimin e shumave nga provimet e aftësive profesionale dhe transferimin mes llogarive të Bordit.

4. Çelja e llogarive do të realizohet në emër të BMP si person juridik.
5. Transaksionet në bankë në emër të BMP do të realizohen me firmë të Kryetarit të BMP dhe drejtuesit të financës të SM të ngritur pranë BMP.
6. Kryetari i BMP mund të delegojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kompetencat për kryerjen e transaksioneve tek Drejtori Ekzekutiv, sipas rastit.
7. Këto llogari do të çelen në monedhën kombëtare Lekë dhe në Euro.

Neni 4

Të ardhurat nga pagesa e honorarëve prej audituesve ligjorë

1. Audituesit ligjorë / shoqëritë audituese, për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik do të paguajnë 3 (tre) për qind të shumës së honorarit të faturuar, për secilën njësi NIP, në një të njërin nga llogaritë rrjedhëse të BMP në bankat e nivelit të dytë, për llogari të BMP.
2. Vlera 3 (tre) për qind do të llogaritet mbi vlerën e honorarit të faturës ose faturave të lëshuara ndaj njësive ekonomike me interes publik dhe do të depozitohet në llogari të BMP jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e lëshimit të raportit final të auditimit ose faturës, më e hershmja ndërmjet tyre.
3. Në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi audituesit ligjorë / shoqëritë audituese detyrohen të paguajnë kamatë vonesë në të njëjtën masë me kamatë vonesën e aplikuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë ndaj anëtarëve të vet. Në të njëjtën kohë detyrohen të paguajnë dëmin e shkaktuar ndaj veprimtarisë së BMP-së, shkaktuar nga mospagesa si dhe do të jenë subjekt i masave disiplinore në përputhje me rregulloren “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore” si dhe kuadrin rregullator në fuqi.
4. Përjashtim nga ky dënim bëjnë audituesit ligjorë / shoqëritë audituese të cilët:
 - a) ndodhen në paaftësi paguese;
 - b) kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për të arkëtuar vlerën e faturës së tyre nga klienti, por ende nuk kanë mundur ta arkëtojnë atë;
 - c) kanë bërë marrëveshje me klientin për arkëtimin e vlerës së faturës me këste.

5. Të gjitha rastet përjashtuese miratohen me vendim të BMP pasi audituesit ligjorë / shoqëritë audituese të kenë njoftuar përmes një kërkesë me shkrim pamundësinë e kryerjes së pagesës brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
6. Në rastet kur njoftimi është bërë brenda afatit 45 ditor të lejuar nga kjo rregullore, nuk do të aplikohen masat e parashikuara sipas pikës 3 të këtij neni deri në datën e mbledhjes së BMP për të shqyrtuar çështjen dhe marrjen e vendimit nga ana e BMP, me kushtin që audituesi dëshmon që përfshihet në një prej kategorive të pikës 4 të këtij neni duke dorëzuar evidencat mbështetëse mbi të cilën ka bërë kërkesën.
7. Në rast se Bordi, nga evidenca e dorëzuar prej audituesit ligjor/ shoqërisë audituese së bashku me kërkesën për tu përjashtuar nga dënimi, nuk bindet për evidencën e marrë dhe gjykon se kërkesa është e pambështetur, atëherë masat në përputhje me pikën 3 të këtij neni aplikohen sikur kërkesa të mos ishte bërë. Gjithashtu nëse provohet se përgjatë kohës që duhet të shlyej detyrimin ndaj BMP audituesi/shoqëria audituese kanë manipuluar aftësinë e tyre paguese duke tjetërsuar likuiditetin apo duke manipuluar me evidencën e dorëzuar atëherë masat aplikohen sikur kërkesa të mos ishte bërë. Për të gjitha këto raste BMP mund të kërkojë informacion shtesë për tu bindur mbi pretendimin e audituesit apo shoqërisë audituese. Në të njëjtën kohë rastet e manipulimit të informacionit trajtohen sipas rregullores së veçantë për “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore”, si dhe kuadrin rregullator në fuqi.
8. Me vendim të BMP, për rastet përjashtuese, do të miratohet mënyra e kryerjes së pagesës dhe afatet e reja të saj. Gjatë kësaj kohe BMP ka të drejtën të kërkojë informacione dhe evidenca të përditësuara nga audituesi dhe shoqëria audituese për tu siguruar mbi vijimësinë dhe qëndrueshmërinë e statusit të rastit të përjashtuar sipas dispozitave të pikës 4 të këtij neni.
9. Në momentin e parë që audituesi ose shoqëria e audituese nuk ndodhet më në situatën e rastit përjashtues për pagesën e detyrimit ndaj BMP-së, ajo brenda 5 ditëve kalendarike duhet të kryej pagesën për detyrimin e prapambetur. Nëse pagesa nuk kryhet atëherë zbatohen dispozitat e pikës 3 të këtij neni nga përfundimi i afatit të pagesës.
10. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të regjistruara në regjistrin publik ose që kanë qenë të regjistruara përkohësisht në regjistrin publik përgjatë vitit ushtrimor, duhet të raportojnë dhe dorëzojnë te BMP brenda datës 20 Janar të çdo viti, në lidhje me njësitë me interes publik të audituara prej tyre, informacionin si më poshtë:
 - i. të gjitha misionet/shërbimet, që kanë kryer përgjatë vitit paraardhës;
 - ii. honorarët e specifikuar në kontratat e lidhura me klientët;
 - iii. honorarët e faturuara deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

Formati i detajuar i Pasqyrës së Raportimit të Misioneve përcaktohet në Rregulloren për kontrollin e cilësisë.

11. Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike verifikon saktësinë e informacionit dhe tepricat e detyrimeve ndaj Bordit të Mbikëqyrjes Publike përmes Raportit të Misioneve që Audituesit Ligjor dhe Shoqëritë Audituese dorëzojnë te Bordi i Mbikëqyrjes Publike si dhe informacioneve të tjera krahasuese të marra prej burimeve zyrtare, ligjore apo që rrjedhin prej vendimeve apo rregulloreve të tjera që janë subjekt i miratimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
12. Për të gjitha shkeljet, gabimet apo mungesën e informacionit, të konstatuara apo mosdhënien e informacionit do të zbatohen masat e parashikuara në rregulloren “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore”, si dhe kuadrin rregullator në fuqi.

Neni 5

Të ardhurat nga fonde të tjera nga organizatat profesionale

1. Në mbështetje dhe zbatim të nenit 1, nenit 3 të ligjit për përforcimin e mbikëqyrjes publike ndaj profesionistëve kontabël dhe organizatave profesionale në të cilat këta profesionist aderojnë dhe nenit 4/1 pika a) paragrafi ii) për financimin e këtij aktiviteti në vijim specifikohen shumat e kontributeve prej secilës organizatë:
 - a. Kontributi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë për llogari të BMP përcaktohet me vendim të veçantë të BMP-së mbështetur mbi relacionin e hartuar dhe propozuar nga SM dhe përgjegjësi për financat dhe do të jetë jo më pak se 7 (shtatë) për qind të të ardhurave që organizata ka realizuar gjatë vitit paraardhës. Afati i derdhjes së fondit do të jetë brenda muajit janar të çdo viti¹.
 - b. Organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar do të paguajnë fonde për llogari të BMP. Ky fond përcaktohet me vendim të veçantë të BMP mbështetur mbi relacionin e hartuar dhe propozuar nga SM dhe përgjegjësi për financat dhe do të jetë jo më pak se 7 (shtatë) për qind të të ardhurave që organizata ka realizuar gjatë vitit paraardhës. Afati i derdhjes së fondit do të jetë brenda brenda muajit janar të çdo viti.
2. Organizatat profesionale duhet të raportojnë dhe dorëzojnë te BMP brenda muajit Shkurt të çdo viti, të dhënat:
 - i. Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor paraardhës;
 - ii. Listën e anëtarëve aktiv dhe jo aktiv;
 - iii. Informacion të hollësishëm mbi burimet e të ardhurave.

¹ Ndryshuar me vendim nr. 23 datë 03.06.2019 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

3. Formati i detajuar mbi informacionin e hollësishëm për burimin e të ardhurave përcaktohet në Rregulloren për kontrollin e cilësisë.
4. Për të gjitha shkeljet, gabimet apo mungesën e informacionit, të konstatuara apo mosdhënien e informacionit do të zbatohen masat e parashikuara në rregulloren “Për Investigimin dhe Procedurat për Marrjen e Masave Disiplinore”, si dhe kuadrin rregullator në fuqi.
5. Në mbështetje të nenit 4/1 pika 4 të ligjit për auditimin BMP ka të drejtë të arkëtojë në dhe për llogari të tij 30% të të ardhurave nga gjobat që organizatat profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat e kontabilistëve të miratuar kanë vendosur ndaj anëtarëve të të tyre . Arkëtimi do të bëhet brenda 30 ditëve nga arkëtimi i gjobës nga vetë organizata.

Neni 6

Të ardhurat nga pagesat për masat disiplinore

1. Audituesit ligjorë / shoqëritë audituese ndaj të cilëve është marrë masë disiplinore “dënim me gjobë” me vendim të BMP në përputhje me nenin 55 të ligjit për auditimin, do të depozitojnë për llogari të BMP vlerën e plotë të shumës së gjobës plus shumën e shpenzimeve për të mbuluar procedurat disiplinore në përputhje me pikën 12 të nenit 55 të ligjit për auditimin.
2. Në rastin e masës disiplinore me gjobë, audituesi ligjor ose shoqëria audituese duhet të shlyejë, brenda 2 muajve, masën e gjobës.
3. Përlllogaritja e shpenzimeve do të bëhet nga stafi përgjegjës për financën në SM të BMP duke u mbështetur mbi kostot faktike që rrjedhin prej këtyre shpenzimeve.
4. Në koston e procedurave disiplinore do të përfshihen: a) kostot për orë pune të personave të strukturës mbështetëse të angazhuar në procesin e investigimit, evidentimit dhe në procesin e përpilimit të raportit që i sugjerohet BMP lidhur me shkeljet dhe masat disiplinore si dhe b) të gjitha kostot e transportit apo kosto të tjera të drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta që lidhen me procesin deri në momentin e marrjes së vendimit për gjobë nga BMP. Kostot për orë pune do të përlllogariten mbi koston bruto të pagës apo pagesës që BMP paguan për personelin e saj të brendshëm apo ekspertët e jashtëm.
5. Për audituesit ligjorë / shoqëritë audituese në rast të mosekzekutimit të kësaj mase zbatohet masa disiplinore në përputhje me nenin 4, pika 3 të kësaj rregullore

Neni 7

Të ardhurat nga procesi i provimeve të aftësive profesionale

1. Tarifat e provimeve të aftësimit profesional do të miratohen me vendim të BMP, e cila nuk duhet të jetë më pak se 15,000 Lekë për secilin provim.
2. Tarifat e rishikimit të provimeve të aftësimit profesional, në rastet kur kandidatët do të kërkojnë rishikim të provimit në përputhje me rregullat dhe rregulloret e miratuara nga BMP, do të jenë jo më pak se gjysma e tarifës së paguar për secilin provim. Këto tarifa miratohen me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
3. Tarifa për procesin fillestar të aplikimit për të kryer testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale (për të cilin kandidatët duhet t'i drejtojnë kërkesë me shkrim KPAP-së, në përputhje me rregulloren për funksionimin e KPAP), nuk duhet të jenë më pak se 5,000 Lekë për çdo aplikim. Këto tarifa miratohen me vendim të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
4. Shumat e paguara për procesin e aplikimit drejtuar KPAP dhe shumat e paguara nga kandidatët për testimin e njohurive profesionale do të derdhen në një llogari të veçantë të BMP-së përputhje me nenin 1, nenin 2 dhe nenin 3 të kësaj rregullore.
5. Tepricat e papërdorura nga struktura e krijuar për testimet e kandidatëve për auditues ligjorë dhe kontabilistë të miratuar, të cilat organizohen në kuadër të provimit përfundimtar, deri në momentin e miratimit të kësaj rregullore, do të kalojnë në dhe për llogari të BMP me qëllim mos cënimin e vijimësisë dhe mbikëqyrjes së këtij procesi, si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të BMP-së.

Neni 7/1

Përdorimi të ardhurave nga procesi provimeve të aftësive profesionale

1. Me vendim të BMP, në përputhje edhe me rregulloren për funksionimin e KPAP-së, miratohen të gjitha shpenzimet e nevojshme për administrimin e plotë të procesit të provimeve.
2. Çdo transaksion i nevojshëm për administrimin e procesit të provimit do të realizohet nga personat e autorizuar në përputhje me këtë rregullore, rregulloret e tjera si dhe statutin e miratuar nga BMP.
3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike në kuadër të promovimit të profesionit dhe përmirësimit të cilësisë nga fondet e veta mund të akordojë shpërblime për kandidatët që kanë dalë me rezultate të larta në procesin e dhënies së provimeve të aftësimit profesional.

4. Shpërblimet që do të akordohen për kandidatin e përzgjedhur do të jenë deri në gjysmën e totalit të tarifave të paguara prej tij përgjatë sezonit për provimeve finale të aftësimit profesional.
5. Numri i kandidatëve që do të jenë subjekt i përfitimit të shpërblimeve të mësipërme nuk do të jetë më i madh se 3.
6. Mënyra e përzgjedhjes dhe aplikimit të kandidatëve për të përfituar shpërblimin do të përcaktohen me vendim të veçantë prej BMP-së duke konsideruar kandidatët me rezultatet më të larta në mbyllje të sezonit të provimeve.
7. Kandidatët, të cilët kanë të drejtë për të aplikuar për shpërblim duhet të plotësojnë kushtet minimale si më poshtë:
 - a) duhet të kenë mbyllur me sukses të gjithë ciklin e provimeve finale të aftësimit profesional për Auditues Ligjor.
 - b) duhet që ti kenë kaluar provimet me sukses që herën e parë.
 - c) duhet të kenë një mesatare aritmetike të pikëve të marra në të gjitha provimet jo më të vogël se 75% i pikëve totale.
8. Bordi i Mbikëqyrjes Publike në kuadër të promovimit dhe stimulimit të cilësisë së kandidatëve të regjistruar për KM dhe Auditues Ligjor mund të bëjë marrëveshje me rregullator apo institucione apo subjekte të tjera që duan të kontribuojnë për të promovuar cilësinë, për të akorduar bursa të pavarura nga ajo e BMP-së përmes memorandumeve të bashkëpunimit. Në të gjitha këto raste Struktura Mbështetëse e BMP-së përpara lidhjes së këtyre marrëveshjeve sigurohet që ti paraqes BMP një raport duke trajtuar të gjitha ato çështje që mund të çënonin pavarësinë apo ndonjë konflikt të mundshëm interesi dhe masat që duhen marrë për të ruajtur pavarësinë dhe shmangien e konfliktit të interesit.
9. Në rastin e bursave të akorduara nga institucione apo rregullatorë apo subjekte të tjera përmes memorandumeve të bashkëpunimit fondet do të sigurohen prej këtyre institucioneve, rregullatorëve apo subjekteve të tjera që duan të kontribuojnë për të promovuar cilësinë. Numri i kandidatëve së bashku me mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve që do të jenë subjekt i këtyre bursave do të përcaktohen në marrëveshjet midis Bordit të Mbikëqyrjes Publike dhe institucionit, rregullatorit apo subjektit me të cilët do lidhet marrëveshja.
10. Në fund të procesit të provimeve teprica e fondeve, e papërdorur për administrimin e tyre, do të administrohet nga BMP për ushtrimin e aktivitetit të vet si rregullator dhe mbikëqyrës i profesionit kontabël në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin për auditimin dhe statutin e BMP, në funksion të përmirësimit të cilësisë së punës së tyre.

Neni 8

Fonde të tjera

1. BMP mund të sigurojë burime të tjera financimi me anë të granteve të akorduara në favor të rritjes së sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit.
2. Mënyra e përdorimit të këtyre granteve do të vendoset me vendim të BMP.
3. Me vendim të BMP mund të organizojë trajnime, ëorkshop, publikime dhe mund të gjenerojë të ardhura për të financuar aktivitetin e BMP-së përmes tyre.
4. Në përputhje me pikën 1 të nenit 6, gërma dh) të ligjit për auditimin Bordi Mbikëqyrjes Publike mbikëqyr institucionet e arsimit të lartë, qëndrat e kualifikimit profesional të përmendur në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 25 të ligjit për auditimin, që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional për audituesit ligjor kundrejt një tarife vjetore e cila do të jetë 350,000 Lekë plus 10% të vlerës së paguar prej çdo personi për kursin e kualifikimit të vijueshëm.
5. Në përputhje me pikën 1 të nenit 6, gërma dh) të ligjit për auditimin Bordi Mbikëqyrjes Publike mbikëqyr punëdhënësit e përmendur në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 25 të ligjit për auditimin, që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional për audituesit ligjor, kundrejt një tarife vjetore e cila do të jetë 10,000 Lekë për secilin Auditues Ligjor aktiv (pjesë e regjistrit publik) dhe 5,000 Lekë për secilin Auditues Ligjor të tërhequr përkohësisht nga regjistri publik.
6. Në përputhje me pikën 1 të nenit 52, si dhe me pikën 1 të nenit 6, gërma dh), të ligjit për auditimin Bordi Mbikëqyrjes Publike mbikëqyr institucione të arsimit të lartë, qëndrat e kualifikimit profesional të përmendur në nenin 25 të ligjit për auditimin, që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional për kontabilistët e miratuar kundrejt një tarife vjetore e cila do të jetë 150,000 Lekë plus 10% të vlerës së paguar prej çdo personi për kursin e kualifikimit të vijueshëm.
7. Në përputhje me pikën 1 të nenit 52, si dhe me pikën 1 të nenit 6, gërma dh) të ligjit për auditimin Bordi Mbikëqyrjes Publike, , mbikëqyr punëdhënësit e përmendur në nenin 25 të ligjit për auditimin, që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional për kontabilistët e miratuar, kundrejt një tarife vjetore e cila do të jetë 5,000 Lekë për secilin Kontabilist të miratuar aktiv (pjesë e regjistrit publik) dhe 2,000 Lekë për secilin Kontabilist të miratuar të regjistruar si jo aktiv në organizatën profesionale të kontabilistëve të miratuar.
8. Përveç fondeve të përshkruara shprehimisht në këtë rregullore, BMP mund të sigurojë të ardhura të tjera në përputhje me këtë rregullore apo që vijnë si rrjedhojë dhe në përputhje me kërkesat ligjore, statutore dhe rregulloreve të tjera subjekt i miratimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

9. Fondet e trashëguara të Bordit të Mbikëqyrjes Publike të cilat mbahen në llogaritë e organizatave profesionale, përpara hyrjes në fuqi të ligjit, do të kalojnë në dhe për llogari të BMP, shoqëruar me vendimet përkatëse për tepricat e krijuara, duke filluar më dhe para vitit 2016.

Neni 9

Kostot e transaksioneve

1. Të gjitha të ardhurat që vijnë nga burimet e të ardhurave që janë përmendur në këtë rregullore do të bëhen përmes transaksioneve bankare duke u derdhur në llogaritë përkatëse të BMP.
2. Shumat e derdhura në llogaritë e BMP në përputhje me këtë rregullore apo që vijnë si rrjedhojë e kërkesave të rregulloreve të tjera apo vendimeve të BMP do të jenë në vlerën neto dhe të gjitha kostot e transaksioneve bankare do të mbulohen nga pala që bënë transfertën.

Neni 10

Të ardhura nga interesat e depozitave

1. Me propozim të zyrës së financës BPM mund të miratoj çeljen e depozitave në një nga Bankat e nivelit të dytë me qëllim gjenerimin e të ardhurave nga interesat.
2. Zyra e financës në propozimin që i drejtohet BMP duhet të paraqesë të gjitha alternativat dhe normat e interesit për secilën nga bankat e nivelit të dytë. Në propozimin e paraqitur nga zyra e financës duhet të jepen informacione krahasuese lidhur me normat e interesit, afateve, komisioneve për shlyerjet e parakohshme.
3. Përpara shqyrtimit të alternativave që ofron secila bankë e nivelit të dytë zyra e financës duhet të shqyrtoj raportet e auditimit të lëshuara për pasqyrat financiare të periudhës më të fundit të mbyllur. Në listën e alternativave që do të propozohen BMP për çeljen e depozitave do të përfshihen të gjitha ato banka për të cilat raporti i audituesit ligjor është pa rezerva.

Neni 11

Projektbuxheti për vitin ushtrimor

1. Hartimi i projekt-buxhetit të BMP bëhet nga zyra e financës së BMP dhe miratohet me vendim të Bordit. Në projekt-buxhet parashikohen të ardhurat e siguruara sipas parashikimeve të kësaj rregullore dhe shpenzimet të detajuara sipas funksionit të realizuar nga Struktura Mbështetëse dhe Bordi.

2. Buxheti i BMP si rregull miratohet një herë në vit me përjashtim të rasteve kur përgjatë vitit ka ndryshime të cilat propozohen për tu miratuar nga BMP. Buxheti faktik i realizuar dorëzohet pranë BMP në të njëjtën datë me dorëzimin e pasqyrave financiare për vitin e kaluar.
3. BMP miraton një herë në vit buxhetin e KPAP për realizimin e procesit të provimeve të aftësisë profesionale bazuar në parashikimet e viti aktual dhe buxhetin faktik të vitit paraardhës.

Neni 12

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese që kanë kryer misionet auditime pranë NIP duhet të derdhen në llogaritë e BMP detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore për misionet e auditimit të kryera dhe të faturuara pas hyrjes në fuqi të ligjit deri në 31 Dhjetor 2017, jo më vonë se data 31 Mars 2018. Në rast vonese do të zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 4, pika 3 të kësaj rregullore.
2. Organizatat profesionale duhet të derdhen në llogaritë e BMP detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore jo më vonë se data 31 Mars 2018. Në rast vonese do të zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 4, pika 3 të kësaj rregullore.
3. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese që kanë kryer misionet auditime pranë NIP duhet të depozitojnë informacionin e kërkuar të përcaktuar në nenin 4, pika 10 të kësaj rregullore për vitin 2017 jo më vonë se data 31 Mars 2018. Në rast vonese do të zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 4, pika 12 të kësaj rregullore.
4. Zbatimi i kërkesave të kësaj rregullore që lidhen me nenin 5, pika 1 do të zbatohen për vitin e plotë që mbyllet më 31 Dhjetor 2017 e në vijim.
5. Organizatat profesionale duhet të depozitojnë informacionin e kërkuar të përcaktuar në nenin 5 pika 2 të kësaj rregullore jo më vonë se data 31 Mars 2018. Në rast vonese do të zbatohen dispozitat e plota të parashikuara në nenin 5 të kësaj rregullore.
6. Të gjitha çështjet në këtë rregullore të cilat nuk janë parashikuar as në rregulloret e tjera do të rregullohen me vendime të veçanta të BMP-së si dhe nga legjislacioni në fuqi.
7. Deri në miratimin e rregulloreve të përmendura në këtë rregullore zbatohen kërkesat ligjore përkatëse si dhe vendimet e BMP të marra në përputhje me këto kërkesa ligjore.
8. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Bordi Mbikëqyrjes Publike, Komisioni i Provimit të Aftësive Profesionale, organizatat profesionale që janë subjekt i

mbikëqyrjes së BMP, audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, struktura mbështetëse e BMP-së, si dhe sekretaria teknike e KPAP-së.

9. Këto rregulla janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetin dhe funksionet ligjore të BMP. Në rast konflikti mes kësaj rregullore dhe rregulloreve të tjera, do të prevalojnë dispozitat e kësaj rregullore.

Kryetar

Dritan Fino